



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROÇEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 929/1 Prot.

Tiranë, më 03 /11/ 2016

Lënda : Dërgohen rekomandime mbi zbatimimin e Kodit të Transmetimeve.

Drejtuar : Z. Gentian Sala
Kryetar
Autoriteti i Mediave Audiovizive

Për Dijeni: Komisionit Parlamentar për Punën Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
Kuvendi I Shqipërisë

Nënkomisionit Për Çështjet e të Miturve, Barazisë Gjinore, Dhunës Në Familje, Kuvendi I Shqipërisë

Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri

Agjensisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Avokati I Popullit

Unionit të Gazetarëve Shqiptarë

Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë

Lidhja e Gazetarëve të Shqipërisë

Shoqata e Meidave Elektronike Shqipëtare

Shoqata e Gazetarëve për Drejtësi



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
ëeb: ëëë.kmd.al

I nderuar Zoti Sala!

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me datë 03.10.2016 ka marrë një letër të hapur nga Rrjeti i Organizatave në Mbrojtje të Fëmijëve dhe Grave me lëndë: *“Organizatrat që Mbrojnë të drjtat e grave dhe fëmijëve, kërkojnë zbatimin e Kodit të Transmetimeve Audiovizive në lidhje me publikimin e lajmeve mbi ngjarjet ku janë përfshirë gratë dhe fëmijët viktime”*. Me anë të kësaj letrë ndahet shqetësimi i publikimit të ngjarjeve ku përfshihen fëmijët viktime. Rrjeti i Shoqatave në Mbrojtje të Grave dhe Fëmijëve, duke marrë shkas nga ngjarja tragjike e abuzimit të një vajze të mitur dhe shumë ngjarjeve të tjera, i ka dërguar Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) disa rekomandime, të cilat i janë bërë me dije dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Duke marrë shkas nga kjo ngjarje, ju sjellim në vëmendje se në vitin 2014 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kontribuar me rekomandime për Kodin e Transmetimeve. Disa nga rekomandimet tona janë marrë parasysh duke u përfshirë në Kodin e Transmetimeve. Përsa me sipër, po ju risjellim në vëmendje zbatimin e dispozitave si më poshtë:

1. Transmetimet audiovizive të të gjitha llojeve të respektojnë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit për çdo shkak të mbrojtur nga legjislacioni shqiptar.
2. Transmetimet audiovizive informative nuk duhet të përmbajnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të nënkuptojnë mesazhe diskriminuese për shkakçe si: gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore ose çdo shkak tjetër.
3. OSHMA-të në hapësirën informative, nuk duhet të keqpërdorin grupet vulnerabël, por duhet promovuar një qasje pozitive ndaj grupeve vulnerabël (minoriteteve, grave të dhunuara, personave me aftësi të kufizuara etj.)
4. Në programet kulturore e argëtuese për fëmijët nuk duhet të përdoren terma të cilat nxisin qëndrime paragjyquese.
5. Ndalohet publikimi i reklamave, nëse ato paraqesin haptazi apo në mënyrë të nënkuptuar, qëllim për të diskriminuar për shkaqe të mbrojtura nga legjislacioni shqiptar.



Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERE



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
ëeb: www.kmd.al